



Pranuar / Dorëzuar Punë/oni/Produkti Received/Delivered	06.04.2022	2	viti god year
Organ/Institucioni Organi/Institucija Org./Inst.	1915/2022	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BK/M/S/H/C/K			114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.305/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2640/19 të datës 23.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.525/2019 të datës 09.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Klinës, kundër Vendimit me numër KA.nr.03/2019 të datës 20.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.525/2019 e datës 09.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.nr.03/2019 i datës 20.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës Referent në Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 03.07.2019 ka pranuar Vendimin me numër 163/2019 të U.d. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, lidhur me përfundimin e marrëdhënies se punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim të njëjtit i është njohur e drejta e kompensimit të një

page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila sipas shkresave të lëndës ankuesit i është kompensuar me listën e pagave të muajit korrik 2019.

Kundër Vendimit me numër 163/2019 të datës 03.07.2019 për përfundimin e marrëdhënies së punës, ankuesi më datë 02.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit material, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për realizimin e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë, sipas nenit 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.08.2019 ka nxjerr Vendim me numër KA.nr.03/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin me numër 163/2019 të datës 03.07.2019 të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.03/2019 të datës 20.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 05.09.2019 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë në Këshill është pranuar më datë 09.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.09.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa më datë 30.09.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 21.10.2019 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 23.03.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2640/19 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 09.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 4132/2019 të datës 09.09.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 05.09.2019; Vendimi me numër KA.nr.03/2019 i datës 20.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin e datës 03.07.2019 të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë; Ankesën e datës 02.08.2019 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Akt Emërimit të ankuesit të datës 28.12.2012; Urdhër Obligim për pagesë i datës 31.07.2019; Kërkesë për pagë retroaktive e datës 05.07.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës



30.09.2019; Njoftimin e datës 21.10.2019 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr. 2640/19 të datës 23.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se me Vendimin me numër 163/2019 të datës 03.07.2019 të Gjykatës Themelore në Pejë, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 02.07.2019, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim të njëjtit i është njohur e drejta e kompensimit të një pagë të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila sipas shkresave të lëndës ankuesit i është kompensuar në muajin Korrik 2019. Kjo pagë ankuesit i është njohur në mbështetje të dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Ankuesi, i pakënaqur me realizimin e një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit të njohur me Vendimin me numër 163/2019 të datës 03.07.2019, ka parashtruar ankesë me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për realizimin edhe të dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë, sipas nenit 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 02.07.2019, në kohën kur Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi, dhe rrjedhimisht nuk ka prodhuar pasoja juridike, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për njohjen e të drejtës për realizimin edhe të dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë, në mbështetje të nenit 52 dhe 53 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, është i pa bazuar.

Kolegji në shkresa të lëndës ka gjetur Urdhër Obligimin për Pagesë të datës 31.07.2019 ku shihet se ankuesit i është kompensuar një pagë mujore e njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, si pagë përcjellëse, gjegjësisht 554.95 euro, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë. Po ashtu është konstatuar se me listën e pagave të muajit Janar 2014

ankuesit i është paguar një shpërblimi i përvjetorit (jubile) në vlerë prej 25% të pagesës mesatare në Shërbimin Civil, gjegjësisht 82.50 euro, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Andaj, Kolegji konstaton se organi i punësimit duke i njohur të drejtën ankuesit për realizimin e një pagë mujore të njëhershme në vlerën e pagesës së fundit, dhe të drejtën e kompensimit në emër të shpërblimit jubile sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ka zbatuar drejt ligjin material, dhe rrjedhimisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.03/2019 të datës 20.08.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pa bazuara.

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.305/2022

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

